Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 529/01
Datë 14.12.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 14.12.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Institucionit Aleanca Franceze e Prishtinës, në Prishtinë për periudhën: 14.12.2015 deri 14.12.2018 për të ofruar:

1.1 Gjuhë Frenge.

Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Zgjerimi i hapësirave dhe mjediseve për mësimdhënie.
- Shoqërimi i Diplomës me një suplement ku do të përshkruhen aftësitë e kandidatit sipas niveleve të KEPR.
- Të kërkohët dëshimi penaliteti për personat që punësohen në këtë institucion.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 30.09.2016).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron

dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Institucionit Aleanca Franceze e Prishtinës, në Prishtinë.
- AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani